



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
TATIMEVE

AGJENCIA SHQIPTARE E
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

Nr. 10079 Prot. datë 30.5.2025

Nr. 1253 Prot. datë 30.05.2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE (referuar si “DPT”), institucion juridik publik, në varësi të Ministrisë së Financave (MF), me adresë: Rr. “Gjin Bue Shpata”, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Ilir Binaj**,

DHE

AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (referuar si “AIDA”), krijuar me ligjin nr. 10303, datë 15.07.2010, “Për themelimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me adresë: Rr. “Skerdilajd Llagami”, Ndërtesa nr. 1, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Zj. Laura Plaku (Saro)**,

Këtë e tutje veçmas referuar si “pala” dhe së bashku referuar si “palët”.

Duke marrë në konsideratë,

Përmirësimin e klimës dhe infrastrukturës lidhur me investimet, duke pasur në fokus investitorët e huaj;

Lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve në Republikën e Shqipërisë;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kountribuar në realizimin e qëllimit të këtij memorandum;

Palët bien dakord si më poshtë të lidhin këtë memorandum bashkëpunimi.

Neni 1

Baza ligjore

Palët në këtë Memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10303, datë 15.07.2010, “Për themelimin dhe organizimin e Agjencisë

Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, Ligjin nr.7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkërendimi i veprimeve, sigurimi dhe shkëmbimi i informacionit, kryesisht për investitorët e huaj që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

Përcaktimet e këtij memorandumi nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe për zbatim, të të cilëve lidhet ky memorandum.

Neni 3 Angazhimet e palëve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar për zbatimin e këtij Memorandumi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e investimeve të huaja dhe në mënyrë të veçantë:

DPT dhe AIDA:

- shkëmbejnë informacion për çështje të veçanta, për të cilat institucionet kanë interes të përbashkët, në respektim të ligjeve të posaçme të sipërcituara;
- shkëmbejnë informacion sipas kërkesës me shkresë zyrtare, të dhënat e kërkuara në formë statistikore;
- organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni përkatës;
- organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe të informacioneve në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi.

Neni 4 Mënyra e bashkëpunimit

DPT merr angazhimin të vendosë në dispozicion të AIDA, informacionin lidhur me:

- Numrin total të punësuarve në sektorët e kërkuar, referuar shkresës zyrtare të dërguar nga AIDA;
- Xhiron vjetore të përmbledhur në mënyrë statistikore, referuar shkresës zyrtare të dërguar nga AIDA.
- Numrin aktual të të punësuarve për subjektet të cilët kanë përfituar statusin strategjik.

AIDA merr angazhimin të vendosë në dispozicion të DPT, informacionin lidhur me:

- Numrin e parashikuar të punonjësve për subjektet të cilët kanë përfituar statusin strategjik, me qëllim monitorimin e ndikimit të tyre në punësim.

Neni 5

Pikat e kontaktit dhe komunikimi

Personi i kontaktit me qëllim koordinimin dhe asistimin e veprimeve për realizimin e memorandumit për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve do të jetë Zj. Rovena Rojba (email: rovena.rojba@tatime.gov.al).

Personi i kontaktit me qëllim koordinimin dhe asistimin e veprimeve për realizimin e memorandumit për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve do të jetë Zj. Ornela Gjini (email: ornela.gjini@aida.gov.al).

Komunikimi i palëve do të jetë në formë shkresore, por dhe me mjete elektronike.

Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën, me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 6

Ndryshimi i Memorandumit

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

Neni 7

Informacion dhe të dhëna të ndjeshme

Asnjëra palë, as stafi i tyre përkatës, nuk do t'u komunikojë personave ose organizatave të tjera informacione të ndjeshme që u janë besuar atyre nga pala tjetër gjatë zbatimit të këtij Memorandumi ose nuk do ta përdorin këtë informacion në dobi të individëve ose kompanive private. Kjo dispozitë do të mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të Memorandumit.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, do të arrihet me mirëkuptim, dhe nëpërmjet diskutimeve mes palëve nënshkruese.

Neni 9

Përfundimi i Memorandumit

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 10 Dispozita të fundit

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e palëve.

Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me detyrimet e këtij Memorandumi, si dhe respektimin e zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej tij.

Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme, personi i kontaktit (përgjegjës) të informojë titullarin e institucionit.

Memorandumi hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe dy në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë ____/____/2025.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E TATIMEVE**

**AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT
TË INVESTIMEVE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DREJTOR EKZEKUTIV

Ilir Binaj

Laura Plaku (Saro)

